



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.265/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Elbasan Morina, për shkak të fotografimit të votës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.265/2017 e datës 12.06.2017, me të cilën është pretenduar se Elbasan Morina, ka bërë fotografimin e votës.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së votimit në Malishevë, në qendrën e votimit 3008a/03r, në Drenovc, komisioneri i tyre ka vërejtur fotografimin e votës prej Elbasan Morinës, me numër personal 1240240757. Më këtë rast pretendohet se është bërë shkelje e dispozitave të Kodit Penal, të Rregullës 09/2013 dhe se kemi cenim të fshehtësisë së votës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenin 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në Malishevë, në qendrën e votimit 3008a/03r, në Drenovc, komisioneri i tyre ka vërejtur se Elbasan Morina, me numër personal 1240240757, ka bërë fotografimin e votës.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së. Ankesa e ankuesit nuk gjen mbështetje ligjore për faktin se nuk është materializuar me prova përkatëse materiale.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.265/2017 më datën 13.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*